

Planifikimi minerar: Koncept i ri i paketes se re ligjore per veprimtarine minerare

Ekspert

Prof. SOKOL MATI

PLANIFIKIMI MINERAR

Domosdoshmeria e Planifikimit minerar

Domosdoshmeri e planifikimit te veprimtarise minerare perballe nje konkurrence globale ne rritje, per te orientuar zhvillimin e kesaj veprimtarie ne perputhje me objektivat e zhvillimit te vendit dhe plotesimin e kriterëve te zhvillimit te qendrushem, per te eliminuar konkurrencen fiktive, bllokimin e kapitalit financiar e njerezor, rritjen fiktive te kostos së prodhimit, lehtësuar barrierat administrative, ristrukturuar kapitalin minerar, stimuluar e zhvilluar kete kapital per te rritur zbulimin e rezervave te reja dhe perpunimin ne vend te mineraleve, per te respektuar konceptin e nje ekonomie te lire tregu ne kete veprimtari.

Domosdoshmeri e mbeshtetjes se rritjes ekonomike, bilancit import-eksport, rritjes se punesimit, uljes se varferise;

Domosdoshmeri e mbrojtjes, rehabilitimit te mjedisit, shmangies se rreziqeve minerare dhe përdorimit te sigurtë te tokës duke vlerësuar balancen e zhvillimit te qendrushem ne: -1.zhvillim ekonomik vizionar - 2.mbrojtje mjedisi, turizëm - 3.certifikim nga komuniteti, -4.garanci per perfitime dhe per brezat e ardhshem;

Domosdoshmeri e garantimit te nje veprimtarie minerare te sigurve nga ana teknike, te sigurve per jeten e shendetit te punonjesve te sektorit minerar dhe komunitetit te zonave minerare;

PLANIFIKIMI MINERAR

Domosdoshmeria e Planifikimit minerar



PLANIFIKIMI MINERAR

Elementet e Planifikimit minerar



PLANIFIKIMI MINERAR

Elementet e Planifikimit minerar

- ❑ **Ligj, Nr.10304, Dt.Aktit:15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” Dt.Miratimit:15.07.2010,**
- ❖ **Vendim i KM, Nr.479, Dt.Aktit:29.06.2011, “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË MINERARE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**
- ❖ **Vendim i KM, Nr.347, Dt.Aktit:29.04.2011, “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare”**
- ❖ **Vendim i KM, Nr.364, Dt.Aktit:04.05.2011, “Për përcaktimin e kriterëve, të vlerës minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare dhe të vlerës minimale të investimit e të prodhimit për një leje minerare”**
- ✧ **Urdhër, Nr.305, Dt.Aktit:13.04.2011, “Për procedurat dhe formën e hartimit të programit të veprimit për zbatimin e strategjisë minerare”**
- ✧ **Urdhër, Nr.306, Dt.Aktit:13.04.2011, “Për procedurat dhe formën e hartimit të planit vjetor minerar”**

PLANIFIKIMI MINERAR

Programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare

Programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare është dokumenti afatmesëm i planifikimit minerar, dhe përmban:

- drejtimet për zhvillimin e sektorit minerar;
- programimin e veprimtarive të kërkimeve themelore gjeologjike;
- promovimin e zonave minerare, për të cilat do të jepen lejet minerare, përmes procesit të konkurrimit apo procedurave të hapura;
- parashikimin e përgjithshëm të produktit vjetor në sektorin minerar;
- Respektimin e zonave të mbrojtura, tokave me nivel IV të bonitetit, infrastruktures, zonat e rrezikshme minerare; ujrat, trashëgimie kulturore, etj.
- Tabelën me vlerat minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar të lejeve minerare, vlerën minimale të investimit për lejet minerare të kërkim-zbulimit, si dhe vlerat minimale të prodhimit të mineralit për lejet e shfrytëzimit, për zonat konkurruese dhe zonat e hapura, sipas grupeve të mineraleve.

PLANIFIKIMI MINERAR

Kriteret e përcaktimit të zonave minerare

Kriteret e përcaktimit të zonave minerare kanë karakter:

- Teknik,
- Ekonomik
- Financiar

a) për zonat konkurruese, në kapacitetin e njohur të rezervave minerare, interesin për llojin e mineralit, leverdinë ekonomike të prodhimit të produkteve të gatshme, vlerën e investimit të kërkuar, objektivat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe planifikimin e territorit;

b) për zonat e hapura, në mundësinë e gjetjes së rezervave të reja minerare, interesin e veçantë të subjekteve, objektivat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe planifikimin e territorit;

c) për zonat e koncesionit ne objekte te zhvilluara me pare dhe përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

PLANIFIKIMI MINERAR

AGGREGATET –MINERALET NDERTIMORE

Mineralet ndertimore jane pjese e strategjise se te gjithe mineraleve.

Ne legjislacionin minerar perfshihen disa minerale qe perdoren si agregate si gelqeroret, zhuret, etj.

Zhvillimi I veprimtarive te shfrytezimit te agregateve perfshin dhe shfrytezimin e shtrateve te lumenjeve per rehabilitim qe monitorohet nga Ministria e Mjedisit.

Eshte e rëndesishme nje planifikim I mirestudiuar per shfrytezimin e agregateve te shtrateve te lumenjeve I cili jo vetem te garantoje perfitim ekonomik por te kete si parim baze rehabilitimin ambiental, eliminimin e permbytjeve, masat mbrojtese per mos demtim te infrastruktures, etj.

PLANIFIKIMI MINERAR

AGGREGATET –MINERALET NDERTIMORE

Domosdoshmeria e nje planifikimi te vecante per agregatet:

- ✧ Shperndarja e planifikimit ne dy legjislacione dhe tre institucione.
- ✧ Specifikat e vecanta ne planifikim dhe specifik te produkteve te agregateve.
- ✧ Mungesa e nje vleresimi sipas standarteve EFG apo te fizibilitetit ka natyre te ndryshme nga mineralet e tjere.
- ✧ Domosdoshmeria e nje VNM me te detajuar pasi dhe ndikimi I tyre ne mjedis (demtim pyje, peisazhim ndikim ne ujera, ambient etj) eshte shume me I madh
- ✧ Rivleresim te rezervave jo vetem ne aspektin e burimit minerar por dhe te atij ekonomik dhe te lidhur me strategjite nacionale te zhvillimit te infrastruktures dhe levizjeve te popullsisë.
- ✧ Kerkohet nje transparence dhe diskutim I vecante me publikun qe veprimtaria te marre nje certifikim real social
- ✧ Kordinim ndermjet aktoreve dhe grupeve te interesit
- ✧ Roli rregulator pavaresisht tregut duhet te luaje nje rol te rendesishem
- ✧ Domosdoshmeria e riciklimit

Legjislacioni i aplikueshem per veprimtarine minerare ne Shqiperi

Aktet ligjore baze per nje veprimtari minerare ne Shqiperi:

Legjislacioni minerar

LIGJI Nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”;
12 Vendime te Keshillit te Ministrave;
21 Urdhera te Ministrit te Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes;

Legjislacioni mjedisor


Ligji, Vendime te Keshillit te Ministrave dhe urdheresat per mbrojtjen e mjedisit;

Legjislacioni fiskal

Legjislacioni shqiptar financiar per nje veprimtari prodhuese, perpunuese ne Republikën e Shqiperise, Ligji nr. 9975, date 28.07.2008 “Per taksat Kombetare” dhe aktet nenligjore te tij;

Legjislacioni i punes

Kodi i Punes, Ligjet, aktet nenligjore per sigurine ne pune, mbrojtjen e shendetit te punonjesve;



Paketa e re ligjore per veprimtarine minerare ne Shqiperi- **Konceptet e reja**

Percaktimi i parimit te zhvillimit te qëndrueshëm;

Percaktimi i sakte i pronesisë se shtetit per sipërfaqen dhe objektet e burimeve minerale;

Percaktimi i dhënies se te drejtave minerare sipas dy parimeve “te konkurimit” dhe “i pari në kohë, i pari në të drejta”;

Percaktimi i dhënies se te drejtave minerare sipas planifikimit minerar te mbështetur ne planifikimin territorial;

Percaktimi i grupimeve te reja te mineraleve;

Percaktime te reja per sipërfaqen e zones se lejuar minerare, afatet fillestare te lejeve minerare, shtyrjeve te afatit dhe kushteve te tyre;

Percaktimi i institucionit te QKL per dhënien e te drejtave minerare, shtyrjet ne afat, dhe shendrimin e lejeve minerare te kerkim-zbulimit ne leje shfrytezimi, dhe autorizimeve nga Ministri pas vleresimit te kushteve te lejimit nga institucionet e SHGJSH per lejet e kerkim-zbulimit dhe AKBN per lejet e shfrytezimit dhe kerkim-zbulim-shfrytezimit dhe te aktit te miratimit te ministrit;

Percaktimi i garancive financiare te verpimtarise minerare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe për realizimin e investimit;

Percaktimi i realizimit te veprimtarive studimore-projektuese-zbatuese;

Percaktimi i Servitutit minerar te detyrueshem per zonen e lejuar minerare, ndryshimit për interes publik te pronësisë së sipërfaqes së zonës së lejuar të një leje minerare dhe Servitutit minerar te detyrueshem mbi pasuritë e paluajtshme fqinje per kalimin ne zonen e lejuar minerare;

Adaptimin e direktivës 2006/21/EC te Këshillit te Parlamentit Evropian te 15 Marsit 2006 mbi menaxhimin e mbetjeve minerare;

Percaktimet ligjore per realizimin e detyrimeve ne kuadër të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse;

Percaktimet ligjore per dhënien me ankand te mbetjeve minerare të ish-ndërmarrjeve shtetërore minerare te përfutuara prej proceseve të shfrytëzimit të minierave apo nga proceset e përpunimit të mineraleve;

Percaktimet ligjore per Kadastren minerare si një regjistër te veçantë inventarizimi sistematik i të dhënave për sendet e paluajtshme, mbështetëse të veprimtarisë minerare, (tokë, ndërtesa dhe instalime të sipërfaqes apo nëntokës), në aspektin teknik, ekonomik, dhe të dhëna të tjera për zonat e lejuara minerare;

Permirësime ligjore per aspekte te rrezikut minerar, sigurise ne pune, rehabilitimit te zones minerare, mbikqyrjes, monitorimit dhe postmonitorimit minerar.

STRATEGJIA MINERARE

Strategjia e BE per lëndet e para

Aktualisht Bashkimi Europian nuk ka një strategji minerare për të gjithë mineralet. Strategjia e lëndëve të para minerale përfshin kryesisht mineralet ndërtimore (Agregatet).

Strategjia e BE është e drejtuar prej konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm, ku planifikimi mineral bazuar në principet e planifikimit territorial po marrin një rëndësi të veçantë nën moton **"Planifikimi është Qëndrueshmëri"**.

Komisioni Evropian më 4 Nëntor 2008, nisi përgatitjen e studimit për një strategji të re të integruar për BE që bazohet në tre shtylla

- a) Sigurimi i aksesit për shfrytëzimin e lendeve të para në mënyrë, që të nxisë burime të qëndrueshme të furnizimit me burime minerale;**
- b) Rritja e shfrytëzimit racional dhe efektiv të burimeve minerare;**
- c) Promovimin e riciklimit për të reduktuar konsumin e BE-së ndaj lëndëve të para të papërpunuara dhe uljen e varësisë relative prej importit.**

çeshtjet ne diskutim

- ✓ Konsiderimin e **komponentëve të ndryshëm të politikave nacionale** për prioritetet e përdorimit të tokës;
- ✓ Mbrojtjen e **ambientit**;
- ✓ Nevojat për burime minerare dhe **diversifikimin** e këtyre burimeve;
- ✓ **Sfidat** e sektorit mineral;
- ✓ Rritjen e **transparencës** së sektorit;
- ✓ Vlerësimin e mineraleve **deficitare** dhe masën në përqindje të tyre;
- ✓ Promovimin e **investimeve** në sektorin mineral
- ✓ Aspektet e **mjedisit, sociale**, të drejtat e njeriut, problematikat e **punës së të miturve**, dhe përgjegjësitë sociale të kompanive (**CSR**);
- ✓ Krijimi i **institucioneve** të shërbimeve për biznesin mineral;
- ✓ Hartimin e një strategjie për **inovacionin industrial**;
- ✓ Menaxhimin e **partneriteteve** europiane duke iniciuar dialogun politik;
- ✓ Inkurajimin e **bashkëpunimit** ndërmjet institucioneve gjeologo mine rare të rajonit dhe më gjërë;
- ✓ Promovimin e **riciklimit** dhe aplikimit të **teknologjive të reja** dhe inkurajimin e përdorimit të materialeve dytësore;
- ✓ Forcimin e respektimit të kërkesave për trajtimin e depozitimin e **mbetjeve** minerare.

STRATEGJIA MINERARE

Srategjia minerare e Republikës së Shqipërisë

Qëllimi final i zhvillimit të veprimtarive minerare është **“Përfitim maksimal të shtetasve shqiptarë nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm, vizionar dhe afatgjatë të tyre dhe realizimit të një shfrytëzimi racional, energji-efiçent, të mbikqyrur, të monitoruar, jo dëmtues ndaj mjedisit dhe të certifikuar nga komuniteti të burimeve minerale dhe mbetjeve të tyre duke marrë në konsideratë përfitimet e këtij brezi dhe të brezave të ardhshëm”**.

- shfrytëzimin racional të pasurive natyrore si pasuri të papërsëritshme;
- Planifikimin mineral për zhvillimin e qëndrueshëm, vizionar dhe afatgjatë;**
- rritjen e të ardhurave nga industria minerare;
- plotësimin e kërkesave gjithnjë në rritje për lëndë të para;
- nxitjen dhe tërheqjen e investimeve sidomos në kërkim-zbulim;
- shtimin e vlerës së mineraleve në vend nëpërmjet thellimit të përpunimit të tyre;
- rritjen e punësimit dhe uljen e varfërisë;
- përballimin e sfidave mirëqeverisjen;
- gjithëpërfshirjen në vendim-marrje,
- rritjen e transparencës
- ristrukturimin e kapitalit mineral;
- aplikimin e teknologjive të reja;
- dhe përgatitjen profesionale të potencialit njerëzor.

STRATEGJIA MINERARE

Arsyet per zhvillimin e veprimtarise minerare

- ✧ Shqipëria është një vënd i pasur me burime minerale;
- ✧ Shqipëria ka nje potencial njerezor te ri dhe te kualifikuar;
- ✧ Aktualisht industria minerare eshte nje industri e cila ka dale nga kushtet e kolapsit dhe krizes se saj;
- ✧ Industria minerare ju pergjigj ne kohe ndryshimit te kerkeses ne treg;
- ✧ Eshte krijuar nje baze e re ligjore;
- ✧ Veprimtaria minerare ka nje baze te plote rregullatore;
- ✧ Jane krijuar kushte optimale për bashkëveprim rajonal dhe me gjere;
- ✧ Ecuria e zhvillimit te vendit , reformat fiskale, integrimi ne BE, anëtarësimi në NATO ne 2009, kane ulur nivelin e rrezikut te investimeve ne vend;
- ✧ Situata aktuale e tregut minerar;
- ✧ Rritje te interesit te biznesit per sektorin minerar dhe shfrytezimin e pasurive minerale;
- ✧ Pozicionimi gjeografik krijon akses ne tregun rajonal dhe boteror;
- ✧ Zhvillimet e infrastruktures se transportit sidomos ne zonat minerare ne keto dy dekadat e fundit;
- ✧ Sistemi bankar ka filluar te konsolidohet.